



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.12

Datë 23 shkurt 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.78, datë 8.2.2006	Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike.....	397
Vendim i KM nr.87, datë 15.2.2006	Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetës me rimbursim.....	398
Vendim i KM nr.88, datë 15.2.2006	Për përcaktimin e përbërjes strukturore dhe shpërblimin e Këshillit Kombëtar të Sportit.....	398
Vendim i KM nr.90, datë 15.2.2006	Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të institucioneve shëndetësore të varësisë, për furnizimin e tyre me pajisje mjekësore, medikamente, gaze mjekësore dhe materiale mjekësore konsumi.....	399
Vendim i KM nr.92, datë 15.2.2006	Për ngritjen dhe funksionimin e Akademisë Diplomatike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë.....	400
Vendim i KM nr.93, datë 15.2.2006	Për financimin me një grant, për një periudhë njëvjeçare të Urdhrit të Farmacistëve.....	401
Vendim i KM nr.94, datë 15.2.2006	Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion të Këshillit të	402

	Ministrave.....	
Vendim i KM nr.95, datë 15.2.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.15l, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin “Dëshmor i Atdheut”, të ndryshuar..... ...	405
Vendim i KM nr.97, datë 15.2.2006	Për përbërjen e Komisionit Qeveritar të Tokës.....	406
Vendim i GJK nr.2, datë 16.2.2006	Me objekt shfuqizimin i vendimeve nr.319, datë 25.3.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.2143, datë 29.12.2004 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese	407
Vendim i GJK nr.3, datë 20.2.2006	Me objekt shfuqizimin i kreut të V-të të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si i papajtueshëm me Kushtetutën.	409

VENDIM
Nr.78, datë 8.2.2006

PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e maturës shtetërore, e cila realizon provimet e pjekurisë në përfundim të arsimit të mesëm 4 dhe 5-vjeçar, nëpërmjet vlerësimit të jashtëm. Matura shtetërore të përbëhet nga:

- a) provime të detyruara,
- b) provime me zgjedhje.

2. Arsimi i mesëm quhet i përfunduar kur nxënësi arrin rezultate kaluese në provimet e detyruara.

3. Kanë të drejtë të kërkojnë që të vazhdojnë studimet në shkollat e larta publike, vetëm ata kandidatë, të cilët kanë kryer provimet e maturës shtetërore ose ekuivalentet e saj, për nxënësit, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit.

4. Ngritjen e Komitetit të Maturës Shtetërore, pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për drejtimin dhe organizimin e provimeve të maturës shtetërore, përbërja dhe detyrat e të cilit caktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

5. Pranimet në shkollat e larta publike, si rregull, të mbështeten në rezultatet e shkollës së mesme, sipas kësaj skeme:

- a) 20 për qind në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- b) 80 për qind në mesataren e notave të provimeve të maturës shtetërore.

6. Për vitin 2008 e në vazhdim pranimet në shkollat e larta publike, si rregull, të mbështeten në rezultatet e shkollës së mesme, sipas kësaj skeme:

- a) 35 për qind në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme;
- b) 65 për qind në mesataren e notave të provimeve të maturës shtetërore.

7. Përzgjedhja e kandidatëve për t’u pranuar në shkollat e larta publike të mbështetet në kriteret e përgjithshme, të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, pas këshillimit me shkollat e larta publike. Këto shkolla mund të përcaktojnë kriteret e veçanta, në përputhje me kriteret e përgjithshme. Për kriteret e veçanta duhet të merret mendimi i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

8. Për shkollat e larta ushtarake dhe për shkollat e larta të policisë kriteret e veçanta vendosen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe, përkatësisht, nga Ministri i Mbrojtjes e nga Ministri i Brendshëm, në përputhje me nenet 2, 3 e 8 të kreut I, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Efektet financiare:

a) për provimet e maturës shtetërore, të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe nga tarifa e provimit me zgjedhje;

b) për pranimet e kërkesave për studim në shkollat e larta publike, të mbulohen nga buxheti i shkollave të larta dhe nga tarifa përkatëse.

Tarifat e mësipërme të përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Financave.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

11. Të gjitha aktet nënligjore për provimet e pjekurisë, të parashikuara në kreun V të dispozitave normative për arsimin parauniversitar dhe urdhrat që mbështeten në to, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.87, datë 15.2.2006

PËR ADMINISTRIMIN DHE MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË RECETËS ME RIMBURSIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 36 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Receta me rimbursim është dokumenti, kundrejt të cilit realizohet mbulimi i çmimeve të barnave nga skema e sigurimeve shëndetësore.

2. Plotësimi i recetës me rimbursim bëhet sipas udhëzimeve të Ministrit të Shëndetësisë dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, ndërsa ekzekutimi i saj bëhet në farmacitë/agjencitë farmaceutike të rrjetit të hapur, që kanë kontratë me ISKSH-në.

3. Receta me rimbursim jepet për pacientët e siguruar, kundrejt një tarife prej 100 (njëqind) lekësh. Kjo tarifë paguhet nga pacienti në farmacinë/agjencitë farmaceutike të rrjetit të hapur, që kanë kontratë me ISKSH-në. Të ardhurat e realizuara kalojnë në llogari të ISKSH-së.

4. Format i dhe përmbajtja e recetës me rimbursim, të plotë dhe të pjesshëm, përcaktohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor. ISKSH-ja merr përsipër prodhimin dhe shpërndarjen e tyre.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.88, datë 15.2.2006

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTURE DHE SHPËRBLIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përbërjes strukturore të Këshillit Kombëtar të Sportit, i cili të kryesohet nga zëvendësministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në përbërje të ketë 14 anëtarë si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------|
| - Zëvendësministrin e Financave | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Shëndetësisë | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Brendshëm | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Mbrojtjes | anëtar; |

- Drejtorin e Sportit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve anëtar;
 - Presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit anëtar;
 - Presidentin e Federatës Shqiptare të Basketbollit anëtar;
 - Presidentin e Federatës Shqiptare të Volejbollit anëtar;
 - Presidentin e Federatës Shqiptare të Atletikës anëtar;
 - Presidentin e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes anëtar;
 - Presidentin e Federatës Shqiptare të Boksit anëtar;
 - Presidentin e Komitetit Olimpik Shqiptar anëtar;
 - Rektorin e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” anëtar;
 - Një specialist nga Drejtoria e Sportit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve koordinator/ sekretar.
2. Këshilli Kombëtar i Sportit thirret si rregull nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, jo më shumë se 4 herë në vit.
3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.90, datë 15.2.2006

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË TË KRYEJË PROCEDURAT E PROKURIMIT, NË EMËR TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE TË VARËSISË, PËR FURNIZIMIN E TYRE ME PAJISJE MJEKËSORE, MEDIKAMENTE, GAZE MJEKËSORE DHE MATERIALE MJEKËSORE KONSUMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë që, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2006, të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të institucioneve shëndetësore të varësisë, për furnizimin me pajisje mjekësore, medikamente, gaze mjekësore dhe materiale mjekësore konsumi, sipas nevojave, për këtë vit, të institucioneve shëndetësore.
2. Ministria e Shëndetësisë të prokurojë fondin e përgjithshëm, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuara për çdo ent varësie, në Buxhetin e Shtetit të vitit 2006, për materialet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Kontratat me subjektet fituese, pas përfundimit të procedurave të prokurimit nga Ministria e Shëndetësisë, të lidhen nga institucionet, në emër të të cilave është zhvilluar prokurimi, për fondin e vënë në dispozicion dhe sipas nevojave të paraqitura prej tyre.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.92, datë 15.2.2006

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E AKADEMISË DIPLOMATIKE PRANË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme,

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e Akademisë Diplomatike në varësi të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Akademia Diplomatike është qendra e trajnimit, kualifikimit dhe rikualifikimit, akademik dhe profesional, të të gjithë punonjësve të shërbimit me jashtë, punonjësve të institucioneve të administratës publike, të nivelit qendror apo vendor, institucioneve të pavarura, zyrtarëve të tjerë nga vendet e rajonit, dhe nga vende të tjera, në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

3. Akademia Diplomatike harton dhe zbaton programet arsimore të trajnimit, kualifikimit dhe rikualifikimit të punonjësve të shërbimit me jashtë dhe atyre të administratës publike, të nivelit qendror dhe vendor, apo të institucioneve të pavarura.

4. Akademia Diplomatike ka si detyrë të organizojë:

a) trajnime afatgjata formimi, me karakter akademik dhe profesional, për nëpunësit e sapopranuar në shërbimin e jashtëm, në mënyrë të veçantë, kurse dhe stazhe, si pjesë integrale të periudhës së provës, me një zgjatje kohore fillestare të paktën gjashtë muaj;

b) kurse afatshkurta për punonjësit e shërbimit me jashtë, të emëruar në përfaqësitë diplomatike, përpara marrjes së detyrës, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë faktorit “gjuhë e huaj”;

c) trajnimin e diplomatëve, sipas gradave përkatëse dhe ndarjes modulare, të përcaktuar nga çdo drejtori. Ky trajnim është i detyrueshëm për të gjithë diplomatët, që shërbejnë në shërbimin me jashtë;

ç) trajnimin e të gjithë nëpunësve, që nuk bëjnë pjesë në shërbimin e jashtëm dhe emërohen në përfaqësitë diplomatike për nevoja pune. Trajnimi do të kryhet sipas gradave përkatëse dhe në funksion të detyrave, që do të mbulojnë këta nëpunës në përfaqësi;

d) trajnimin dhe ofrimin e ndihmës, akademike dhe hulumtuese, për të gjithë diplomatët, që përgatiten për marrjen e një grade më të lartë;

dh) trajnimin e zyrtarëve të tjerë, të administratës publike, të nivelit qendror apo vendor, dhe të institucioneve të pavarura, të cilët merren me marrëdhëniet me jashtë;

e) trajnimin e stafit mbështetës, sekretarë dhe asistentë, për çështje administrative dhe mbështetëse të diplomacisë;

e) trajnime për zyrtarë të tjerë, nga vendet e rajonit dhe vende të tjera, sipas kërkesës dhe nevojave, duke u bazuar në marrëveshjet përkatëse.

f) kërkime dhe studime me karakter akademiko-shkencor në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, në lidhje me përparësitë bazë të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë. Këto studime dhe hulumtime i dorëzohen Ministrit të Punëve të Jashtme, për të përcaktuar zbatimin apo jo të përfundimeve dhe rekomandimeve që dalin nga to.

5. Personeli i Akademisë Diplomatike përbëhet nga një staf prej 4 nëpunësish, që janë: drejtori i Akademisë dhe tre specialistë, të cilët do të merren me funksionimin dhe menaxhimin e plotë të saj.

6. Drejtori i Akademisë Diplomatike emërohet në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Krahas kërkesave të parashikuara në ligjin “Statusi i nëpunësit civil”, drejtori duhet të jetë kërkues shkencor ose profesor universiteti, i diplomuar në degën e marrëdhënieve ndërkombëtare apo shkencave politike dhe të ketë, të paktën, një gradë shkencore. Specialistët e Akademisë Diplomatike emërohen po në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Të paktën njëri prej tyre duhet të jetë diplomat.

7. Pranë Akademisë Diplomatike vepron këshilli drejtues, i cili përbëhet nga: Ministri i Punëve të Jashtme, drejtori i Akademisë, një anëtar i Komisionit të Kuvendit për Politikën e Jashtme, si dhe dy diplomatë karriere dhe dy personalitete nga fusha akademike e marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilët emërohen nga Ministri i Punëve të Jashtme. Këshilli kryesohet nga Ministri i Punëve të Jashtme.

8. Këshilli drejtues harton dhe miraton kurrikulat e Akademisë, ndarjen e lëndëve dhe të degëve dhe modulet bazë për çdo nivel, përfshirjen e metodave të reja të mësimdhënies në Akademi, stafin mësimdhënës, donacionet e huaja për zhvillimin e Akademisë dhe detyra të tjera për funksionimin e brendshëm të saj.

Këshilli drejtues bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në kurs, siguron burimet njerëzore dhe

materiale dhe kryen programimin didaktik të kurseve.

9. Akademia Diplomatike bashkëpunon me institucione homologe të vendeve të tjera, me universitete publike dhe jopublike, vendase dhe të huaja, për shkëmbim përvoja dhe për sigurimin e lektorëve, vendas dhe të huaj.

10. Veprimtaria e Akademisë Diplomatike mbështetet në rregulloren e posaçme, të hartuar nga këshilli drejtues dhe të miratuar nga Ministri i Punëve të Jashtme, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e institucioneve të kësaj natyre në Republikën e Shqipërisë.

11. Efektet financiare për veprimtarinë e Akademisë Diplomatike përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe me donacione të ndryshme nga persona, juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, në bazë të marrëveshjeve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

12. Vendimi nr.198, datë 14.4.2004 i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen dhe funksionimin e Akademisë Diplomatike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

13. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.93, datë 15.2.2006

**PËR FINANCIMIN ME NJË GRANT, PËR NJË PERIUDHË NJËVJEÇARE TË URDHRI
TË FARMACISTËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20 të ligjit nr.9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, për një periudhë njëvjeçare, e Urdhrit të Farmacistëve, me një grant prej 12 700 000 (dymbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

2. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2006 zëri “Të tjera transferta korrente, të brendshme”, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.94, datë 15.2.2006

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONET DHE PROCEDURAT E
KONTROLLIT TË BRENDSHËM ADMINISTRATIV DHE ANTIKORRUPSION TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion të Këshillit të Ministrave, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.731, datë 11.11.1998 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ”, i ndryshuar, dhe urdhri nr.252, datë 23.9.2002 i

Kryeministrit “Për riorganizimin dhe funksionimin e grupit të monitorimit antikorrupsion”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR FUNKSIONET DHE PROCEDURAT E KONTROLLIT TË BRENDSHËM ADMINISTRATIV
DHE ANTIKORRUPSION TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

1. Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave në vijim referuar si “Departamenti”, është struktura përgjegjëse për kontrollin e brendshëm administrativ dhe antikorrupsionin në institucionet dhe entet publike të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Misioni i Departamentit është të kryejë verifikimin (hetimin administrativ) e zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose kallëzimeve për praktika abuzive, korruptive a arbitrare, të identifikojë punonjësit e administratës publike, të cilët, me veprime apo mosveprime kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, të përgatisë rekomandime për çështjet përfshi edhe llojin e masave ndaj autorëve, si dhe të ndërgjegjësojë insitucionet publike në luftë kundër korrupsionit.

3. Departamenti verifikon dhe ushtron kontroll në të gjitha ministrinë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit a ministrave, administratës së prefektit, si dhe në shoqëritë tregtare, me kapital, pjesërisht a tërësisht, shtetëror, për aq sa nuk bie në kundërshtim me aktet e tjera ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në këtë fushë.

4. Departamenti ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) të ekzaminojë dhe të analizojë praktikën dhe procedurat e punës në administratën publike, për identifikimin, zvogëlimin dhe parandalimin e mundësive për korrupsion, duke u përqendruar në radhë të parë në fusha të ndjeshme të tij;

b) verifikimin e ligjshmërisë së akteve administrative, të nxjerra nga organet e administratës publike;

c) propozimin, pranë Kryeministrit, të masave administrative të përgjithshme a individuale në përputhje me rezultatet e verifikimeve të kryera;

ç) ndjekjen dhe zbatimin e detyrave, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave apo nga Kryeministri;

d) ofrimin e shërbimeve të këshillimit, të ekspertizës e të trajnimit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, në seminarët dhe takimet e punës për nëpunësit civilë të institucioneve të administratës publike, për njohjen e legjislacionit në fuqi në fushën e parandalimit dhe të luftës kundër korrupsionit, si dhe promovimin e praktikave të mira përgjithësuese;

e) ndërgjegjësimin e administratës publike për çështje të luftës antikorrupsion dhe shmangien e praktikave abuzive;

ë) informimin, përgatitjen e raporteve periodike përmbledhëse për masat antikorrupsion nga ministrinë dhe institucionet në varësi të tyre.

5. Departamenti në një procedurë kontrolli në institucionet e përmendura në pikën 3 të kësaj rregulloreje përqendrohet në:

a) zbatimin e akteve ligjore, në përgjithësi, dhe të akteve ligjore e nënligjore, të nxjerra nga Këshilli i Ministrave dhe Kryeministri, në veçanti;

b) shkeljet administrative dhe rastet e abuzimit të zyrtarëve me autoritetin publik të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

c) zvarritjet, mungesën e bashkërendimit dhe rastet e konfliktit të interesave, ndërmjet organeve të administratës publike;

6. Departamenti kryen detyrat e kontrollit dhe verifikimit në institucionet e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi:

a) sipas një grafiku dhe plani pune, të miratuar nga Kryeministri;

b) për raste të veçanta, me urdhër të Kryeministrit ose me porosi të tij.

Departamenti regjistron në një regjistër të veçantë, të krijuar sipas këtij vendimi çdo procedurë

kontrolli a verifikimi. Regjistri ruhet dhe administrohet në përputhje me ligjin “Për arkivat”.

7. Departamenti harton, për çdo kontroll, programin e kontrollit dhe të verifikimeve, ku përcaktohen institucionet, që do t’i nënshtrohen kontrollit, çështjet, për të cilat do të ushtrohet kontroll, dhe veprimtaritë konkrete ligjore, që do të verifikohen. Programi miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave. Programi mund të ndryshohet në varësi të rezultateve dhe problemeve të ndeshura gjatë procesit të kontrollit. Për ndryshimin e programit informohet me shkrim Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe i kërkohet miratimi i ndryshimit.

8. Drejtuesi i departamentit cakton për çdo procedurë kontrolli a verifikimi grupin e kontrollit me inspektorë dhe për shkak të njohurive të veçanta që kërkon kontrolli a verifikimi i një çështjeje, në grup mund të përfshihen edhe specialistë të ministrave a institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit a ministrave. Kur është e nevojshme përfshirja e specialistëve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, paraqet kërkesën për vendosje në dispozicion të departamentit, të personit, i cili duhet të gëzojë kualifikimet dhe cilësitë e kërkuara, si dhe afatet e kryerjes së misionit. Titullarët brenda afateve të përcaktuara në kërkesë vendosin në dispozicion një specialist i cili përmbush kriteret përkatëse. Veprimtaria e këtyre specialistëve në grupin e kontrollit është pjesë e detyrës, si punonjës a nëpunës të administratës publike.

9. Për çdo procedurë kontrolli apo verifikimi, departamenti hap një dosje të veçantë, e cila përmban çdo dokumentacion të ardhur, të marrë apo të mbledhur, lidhur me praktikën në fjalë. Në përfundim të kontrollit, materiali i dosjes ruhet dhe administrohet sipas ligjit “Për arkivat”.

10. Departamenti sipas rrethanave vendos në çmimin e tij, nëse është e nevojshme të njoftohet paraprakisht organi që do të kontrollohet. Përpara fillimit të kontrollit, inspektorët i komunikojnë titullarit të këtij institucioni urdhrin për fillimin e kontrollit. Titullari i institucionit ia paraqet inspektorët stafit të tij, si dhe ua bën të njohur objektin e kontrollit. Mungesa e titullarit të institucionit nuk përbën shkak për pezullim, ndërprerje apo pushim kontrolli.

11. Gjatë ushtrimit të kontrollit, inspektorët kanë të drejtë të mbledhin informacion dhe të grumbullojnë prova, të cilat bëhen pjesë e dosjes së kontrollit. Inspektorët në ushtrimin e përgjegjësisë së tyre gjatë kryerjes së një hetimi mbledhin prova edhe tek të tretët.

12. Institucioni nën kontroll ka për detyrë të vendosë në dispozicion të inspektorëve të gjitha dokumentet që ata kërkojnë ose kopje të njehsuara me origjinalin e tyre, në kohën dhe mënyrën e kërkuar. Në rastet kur ka pengesë ligjore për njohjen e dokumenteve rasti i dokumenteve të klasifikuara, këqyrja dhe marrja e tyre nga inspektorët bëhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse ose, në bazë të kërkesës, me autorizim të organit përgjegjës, sipas ligjit.

13. Inspektorët dokumentojnë çdo veprim, gjatë kërkimit apo marrjes së dokumentacionit të mësipërm. Dokumentet e mësipërme merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit për dhënie mase disiplinore.

14. Zyrtarët, veprimtaria e të cilëve është nën kontroll, kanë për detyrë të japin sqarime e shpjegime, për çështje që lidhen me objektin e kontrollit, si dhe për fakte e rrethana të tjera që kanë lidhje me to. Shpjegimet dhe sqarimet mbahen me procesverbal, i cili, nënshkruhet nga inspektorët dhe zyrtari. Inspektorët kanë të drejtë të procedojnë edhe me ballafaqimin e zyrtarëve, të cilëve u janë marrë, paraprakisht, sqarime dhe shpjegime. Inspektorët gjatë ushtrimit të detyrës dokumentojnë çdo sqarim apo shpjegim, që u jepet nga persona të tretë. Ballafaqimi i personave të tretë me zyrtarët mund të bëhet në rastin kur personat e tretë pranojnë dhe kur nuk kërkojnë t’u ruhet anonimat.

15. Gjatë procesit të kontrollit apo verifikimit, nëse është e nevojshme, që, për çështje konkrete, të kryhen ekspertime, të natyrave dhe fushave të ndryshme, departamenti, me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, nëse ekspertimi nuk mund të sigurohet nga ekspertë personel i ministrave a institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit a ministrave, angazhon ekspertë, të licencuar apo të njohur si të tillë nga organe shtetërore të specializuara. Këta ekspertë ofrojnë shërbimet e tyre kundrejt pagesës, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

16. Inspektorët e departamentit kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë së zyrtarëve që janë objekt kontrolli a verifikimi. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.

17. Në raste të veçanta, kur inspektorët e kontrollit vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, inspektorët bllokojnë dokumentacionin apo

Nr.95, datë 15.2.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime.

1. Shkronja “a” e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Përbërja e Komisionit Qendror për Statusin “Dëshmor i Atdheut” pranë Këshillit të Ministrave, është si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-------------|
| - Zëvendëskryeministri | Kryetar; |
| - Zëvendësministri i Mbrojtjes | nënkryetar; |
| - Zëvendësministri i Brendshëm | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Drejtësisë | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta | anëtar; |
| - Një përfaqësues i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të LANÇ | anëtar; |
| - Një përfaqësues i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) | anëtar.”. |

2. Në pikat 3, shkronjat “b” dhe “ç”, e 4 emërtimet “Ministria e Rendit Publik” dhe “Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit” zëvendësohet me “Ministria e Brendshme”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM

Nr.97, datë 15.2.2006

PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT QEVERTAR TË TOKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përbërja e Komisionit Qeveritar të Tokës, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Komisioni Qeveritar i Tokës mblidhet jo më pak se tri herë në vit.

3. Vendimi nr.134, datë 26.2.1998 i Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Komisionit Qeveritar të Tokës”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

Lidhja nr.1

PËRBËRJA E KOMISIONIT QEVERTAR TË TOKËS

1. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Kryetar;

2. Zëvendësministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	zëvendëskryetar;
3. Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Tokave dhe Ujërave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	sekretar;
4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit	anëtar;
5. Zëvendësministri i Drejtësisë	anëtar;
6. Zëvendësministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	anëtar;
7. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit të Burimeve dhe Ofrimit të Shërbimeve në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	anëtar;
8. Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	anëtar;
9. Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Qeverisjes Vendore dhe Decentralizimit në Ministrinë e Brendshme	anëtar;
10. Drejtor drejtorie në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
11. Drejtori i Institutit të Studimeve të Tokave	anëtar;
12. Drejtori i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	jurist;
13. Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	anëtar.

VENDIM
Nr.2, datë 16.2.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Mecaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 29.9.2005, 26.10.2005 dhe 30.11.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.38/2 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA “GENERAL INVEST” SHPK përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. TRASHËGIMTARËT E MUHAMET TURDIUT përfaqësuar nga avokat Avni Shehu, me prokurë.

2. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.319, datë 25.3.2004 të Gjykatës së

Apelit Tiranë dhe nr.2143, datë 29.12.2004 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43 e 131/f të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të lartpërmendura:

1. Konform neni 465 të Kodit të Procedurës Civile, kam kërkuar në gjykatën e apelit përsëritjen e pjesshme të hetimit gjyqësor, për të vërtetuar pronësinë time për truallin objekt gjykimi. Gjykata ishte e detyruar ta pranonte kërkesën time;

2. Në kundërshtim me përmbajtjen e neni 451 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit e ka trajtuar kërkesën si gjë të gjykuar, ndonëse në të vërtetë nuk është ashtu;

3. Një gjyqtar që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, ka qenë anëtar i trupit gjykues, në gjykimin e çështjes të konsideruar nga ajo gjykatë si gjë e gjykuar. Gjykata, dhe pse është vënë në dijeni të këtij fakti, ka vazhduar gjykimin duke shkelur kështu kërkesat e neni 72 të Kodit të Procedurës Civile;

4. Në rekurs, janë evidentuar shkelje flagrante të ligjit material dhe procedural, e megjithatë, kolegji seleksionues nuk e ka kaluar çështjen për gjykim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fehmi Abdiun, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1751, datë 23.04.2003, ka pranuar kërkesëpadinë e kërkuesit, ka anuluar vendimin nr.59, datë 23.9.1993 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për sipërfaqen 563.75 m² funksionale të objektit konvenier si truall i zënë, e ka urdhëruar që ish-pronarët e truallit, trashëgimtarët ligjore të Muhamet Turdiut, të kompensohen për këtë sipërfaqe në një nga mënyrat që parashikon ligji. Veç kësaj, ka vendosur anulimin e klauzolës nr.2 të vendimit nr.59, datë 23.9.1993 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për njohjen e së drejtës së parablerjes ish-pronarit, për objektin konvenier.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.319, datë 25.3.2004, ka vendosur ndryshimin e vendimit të lartpërmendur dhe rrëzimin e padisë, duke arsyetuar se gjykata e rrethit gjyqësor ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, në bazë të të cilit ka gjykuar çështjen, pasi sipas saj, Hasan Turdiu, në datën 26.1.1996, ka privatizuar objektin në favor të tij.

Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk ekzistonin shkaqe të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me pretendimet e kërkuesit, që janë objekt i shqyrtimit kushtetues, konform neneve 42 e 131/f të Kushtetutës dhe neni 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut për zhvillimin e një procesi të parregullt, Gjykata Kushtetuese çmon se ato duhet të analizohen veç, sepse në vetvete nuk kanë ndonjë lidhje organike midis tyre dhe se secili, në veçanti në aspektin teorik, ka lidhje me procesin e rregullt gjyqësor.

Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit ishte e detyruar të riçelte hetimin gjyqësor, pasi sipas tij, një gjë e tillë detyrohet nga përmbajtja e neni 465 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata Kushtetuese e sheh të nevojshme, që më parë se të analizojë dhe vlerësojë pretendimin për përsëritjen e hetimit gjyqësor, të parashtrijë një vështrim të shkurtër mbi procedurat dhe afatin e gjykimit në gjykatën e apelit. Gjatë shqyrtimit të kërkesës është konstatuar se Gjykata e Apelit Tiranë ka filluar shqyrtimin e çështjes në datën 26.2.2004 dhe e ka përfunduar në datën 25.03.2004. Gjatë kësaj kohe, ajo ka zhvilluar disa seanca. Në datën 25.3.2005, kur palët do të bënin pretendimet e tyre të fundit, përfaqësuesi i kërkuesit i ka kërkuar gjykatës së apelit të riçelte hetimin gjyqësor me pretendimin se do të sillte prova të reja që të vërtetonte se klienti i tij ishte pronar i objektit me të cilin kishte lidhje objekti i gjykimit të çështjes, por nuk i dispononte akoma.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese konstaton se ky pretendim i tij është i pabazuar. Nga përmbajtja e paragrafit të dytë të neni 465 të Kodit të Procedurës Civile, konstatohet se kjo dispozitë s'ka karakter detyrues. Përsëritja tërësisht apo pjesërisht e hetimit gjyqësor mund të bëhet si me

kërkesën e palëve ose dhe kryesisht kur çmohet se një gjë e tillë mund të shërbejë për një zgjidhje sa më të drejtë të konfliktit, por gjithmonë kur palët nuk kanë pasur mundësi të paraqesin provat për të vërtetuar, deri në momentin e riçeljes, pretendimet e tyre. Në çështjen në shqyrtim, një mundësi të tillë, kërkuesi e ka pasur vazhdimisht gjatë gjithë seancave të gjyqimit, por nuk ka paraqitur prova të tjera.

Veç kësaj, sipas nenit 455 të Kodit të Procedurës Civile, kërkuesi ka pasur mundësinë që, nëse kishte dokumente të tjera, t'i paraqiste ato bashkë me ankimin që ka paraqitur para Gjykatës së Lartë, por as atë nuk e ka bërë.

Sa u parashtrua në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton që pala kërkuese të jetë vënë në pozita të pabarabarta me palët e tjera, gjë që mund ta bënte kushtetues pretendimin e saj.

Të njëjtin vlerësim ka kjo gjykatë edhe në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuetit, sipas të cilit, Gjykata e Apelit Tiranë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, përse i përket zgjidhjes në thelb të çështjes, e kanë konsideruar atë si gjë të gjykuar. Gjatë shqyrtimit të çështjes është konstatuar se as gjykata e apelit dhe as Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimet e tyre, nuk bëjnë fjalë për gjë të gjykuar, sipas konceptit të nenit 451, shkronja "a", paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile. Në këto vendime është arsyetuar se për këtë çështje ekziston një vendim civil i mëparshëm i formës së prerë, që sipas nenit 451, shkronja "a", paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, është i detyrueshëm edhe për gjykatat që gjykojnë çështjen. Ai vendim nuk ka të njëjtat palë, të njëjtin objekt e të njëjtin shkak që ka vendimi objekt i këtij kontrolli konkret. Kundër këtij pretendimi të kërkuetit dëshmon dhe fakti se gjykata e apelit ka analizuar e vlerësuar provat në të cilat ka bazuar vendimin e saj dhe problemet ligjore që kanë të bëjnë me çështjen konkrete.

Në lidhje me pretendimin tjetër se në gjykimin në gjykatën e apelit, nuk duhej të merrte pjesë njëri nga gjyqtarët që ka gjykuar më parë çështjen, sipas tij, të quajtur "gjë e gjykuar", Gjykata Kushtetuese konstaton se një pretendim i tillë, nuk është paraqitur përpara Gjykatës së Lartë. Duke qenë i tillë, ai s'mund të merret parasysh, sepse kërkuesi, nuk i ka ezauruar të gjitha mundësitë që i ofron sistemi i padive dhe i apeliimeve¹, për të cilat bën fjalë neni 131/f i Kushtetutës. Për këtë aspekt të procesit të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një qëndrim konstant, sipas të cilit, nuk mund të bëhen objekt gjykimi në këtë gjykatë pretendime të cilat nuk janë parashtruar përpara gjykatave me juridiksion të zakonshëm².

Në rrethanat e lartpërmendura, kur pretendimet bazë të kërkuetit për një proces të parregullt në gjykatën e apelit nuk vërtetohen, Gjykata Kushtetuese çmon se s'mund të merret parasysh as pretendimi i tij se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duhej ta kalonte çështjen për gjykim. Kolegji, sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, është organi që bën vlerësimin nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për gjykim. Një qëndrim tjetër, i shoqëruar me një vlerësim të ndryshëm nga Gjykata Kushtetuese, do ta vinte këtë të fundit në një pozicion që e largon nga juridiksioni i saj kushtetues.

Përfundimisht, duke qenë se pretendimet e kërkuetit nuk qëndrojnë, kërkesa e tij duhet të rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ Shih vendimin nr.10, datë 2.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

² Shih vendimet nr.9, 10, datë 9.5 .2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

VENDIM
Nr.3, datë 20.2.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 1.12.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.49/8 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E LARTË, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, në mungesë.
2. **KËSHILLI I MINISTRAVE**, përfaqësuar nga Genc Çifligu, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, me autorizim.

3. **KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË**, përfaqësuar nga zotërinjtë Izet Salaj e Luan Dervishi, me autorizim.

4. **THOMA NIKA**, përfaqësuar nga avokat Petraq Curri, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën i kreut të V-të të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të kërkesës për anulimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i kanë kërkuar Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e kreut të V-të të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke argumentuar sa më poshtë:

- Kushtetuta, në nenin 147/6, ka përcaktuar vetë kriteret e shkarkimit të gjyqtarëve, si dhe organin që ka të drejtë ta vendosë atë. Ajo nuk ia ka deleguar këtë kompetencë ndonjë organi tjetër, prandaj, çdo ligj që del duhet t’u përmbahet kriterëve kushtetuese e mos dalë tej përcaktimeve të saj.

- Në nenin 40 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998, janë përcaktuar dy kriterë, për të cilat merren masa, shkelja e disiplinës dhe aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë figurën dhe autoritetin e drejtësisë.

- Formulimi i pikës 41/7, që përcakton si shkelje të disiplinës kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, kur nuk përbën vepër penale, nuk është as plotësim as interpretim i nenit 147 të Kushtetutës.

- Në nenin 46 të këtij ligji bëhet fjalë vetëm për masat e parashikuara në Kushtetutë dhe jo për masat e tjera. Në këto rrethana, përcaktimi dhe rregullimi i këtyre marrëdhënieve në ligj nuk është në përputhje me parimet kushtetuese dhe kryesisht me ato që garantojnë ushtrimin e një drejtësie të pavarur.

Këshilli i Ministrave ka parashtruar se:

- Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk parashtrojnë në kërkesë se cila nga dispozitat konkrete të kreut të V-të, ligjit bie ndesh me Kushtetutën.

- Gjykata e Lartë, në rastin analog, nuk ka kërkuar shfuqizimin e këtyre dispozitave.

- Kreu i V-të i ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i parë në kuptim të paragrafit të katërt të nenit 147 të Kushtetutës, është në përputhje me këtë të fundit, dhe ka dalë në plotësim të kësaj dispozite kushtetuese.

- Me vendimin e tyre, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë bërë vetëm një

interpretim literal dhe të ngushtuar të nenit 147/6 të Kushtetutës.

- Pavarësisht nga terminologjia e përdorur në dispozitat e këtij kreu, ato janë në të njëjtën përmbajtje me nenin 147/6 të Kushtetutës.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka pretenduar se:

- Dispozitat e ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” që kundërshtohen, janë në harmoni me frymën e nenit 147/6 të Kushtetutës dhe me konceptin e saj për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Pavarësisht nga kjo, kreu i V-të i ligjit të sipërpërmendur, duhet të ketë përmirësime, përcaktime më të sakta, në kuptim të zbatimit të drejtë dhe pa ekuivok të tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.159, shkronja “a”, datë 16.07.2004, ka vendosur që gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Thoma Nika, t’i jepet masa disiplinore shkarkim nga detyra, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës. Ky i fundit është ankuar kundër kësaj mase disiplinore në Gjykatën e Lartë. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të kërkesës, kanë vendosur dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, për t’u shprehur mbi pajtueshmërinë me Kushtetutën të kreut të V-të të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata Kushtetuese vëren se kërkesa e paraqitur nga Gjykata e Lartë është në vijim të kërkesës së mëparshme të paraqitur prej saj, mbi të cilën Gjykata Kushtetuese është shprehur me vendimin e saj nr.29, datë 09.11.2005. Nisur nga ngjashmëria që ekziston midis tyre, për shkak të kriterëve kushtetuese të njëjta mbi të cilat ato mbështeten, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e kërkesës e çmon të nevojshme të rikonfirmojë qëndrimin e saj, lidhur me raportin midis normës kushtetuese dhe normës ligjore dhe zbatimin drejtpërsëdrejt të dispozitave të Kushtetutës, sikundër përcaktohet në nenin 4 të saj.

Teoria normativiste e së drejtës ka në thelb të saj idenë se marrëdhëniet midis normave juridike bazohen mbi raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barazvlefshme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike¹. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike².

Kushtetuta, si akt themelor i një shteti, parashikon organet dhe kushtet në të cilat duhet të nxirren aktet normative duke synuar qëndrueshmërinë e tyre. Kushtetuta, mbi bazën e së cilës miratohen të gjitha aktet e tjera normative, mund të ndërmarrë si mision të saj edhe përcaktimin e përmbajtjes së ligjeve që duhet të miratohen në të ardhmen nga ligjvënësi. Kështu, konsiderohet si karakteristikë e kushtetutave të shkruara përcaktimi konkret i disa parimeve kryesore ose përjashtimi absolut i disa rrethanave që konsiderohen si të papranueshme për të³.

Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shtrënguese. Megjithatë disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t’u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore politike të një vendi, por vetëm të parimeve dhe kriterëve bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo.⁴ Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e

¹ Hans Kelsen, Reine Rechtslehre (1960), fq.228

² Vendim nr.29, datë 09.11.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

³ Hans Kelsen, Reine Rechtslehre (1960), fq.230

⁴ Konrad Hesse, Gruendzuege des Verfassungsrechts in BRD (1999), fq.11

mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës, që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga inspektorët dhe zyrtarët përgjegjës. Zhbllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të drejtorit të departamentit.

18. Gjatë ushtrimit të detyrës inspektorët zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, pjesa e pestë, kreu IV, nënseksioni I.

19. Në fund të kontrollit mbahet aktkontrolli, i cili nënshkruhet nga inspektorët dhe zyrtarët e titullari i organit nën kontroll. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit të kontrollit, kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime, të cilat pasqyrohen në përmbajtjen e aktkontrollit. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktkontrollit. Departamenti, me kërkesë me shkrim të titullarit të institucionit në kontroll, pret brenda 5 ditëve pune argumentet, vërejtjet e detajuara rreth përmbajtjes së aktkontrollit.

20. Inspektorët brenda 5 ditëve hartojnë një raport përmbledhës për objektin e kontrollit, ecurinë, gjendjen e konstatuar, si dhe masat që propozohen për shmangien e shkeljeve a të mangësive, si dhe përcaktojnë punonjësit dhe drejtuesit përgjegjës për to, nëse ka. Për çështje ku trajtimi i problemit është kompleks, drejtuesi i departamentit ka të drejtë të caktojë një afat të ndryshëm, pasi ka njohur më parë me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave. Raporti përmban edhe rekomandime për përmirësime të praktikave ose procedurave objekt kontrolli. Ky raport nënshkruhet nga drejtori i departamentit dhe i paraqitet Kryeministrit.

21. Pas konfirmimit nga Kryeministri kopje të aktkontrollit dhe të raportit përmbledhës, të hartuara sipas pikave 19 dhe 20 të këtij vendimi, u dërgohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organit që kontrollohet dhe çdo organi tjetër, që vlerësohet se ka interes për t'u njohur me të, si dhe organit epror të institucionit nën kontroll. Në raste të veçanta, për shkelje të rënda ose për probleme të një rëndësie të veçantë, mund t'i propozohet Kryeministrit, që materialet e kontrollit të analizohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.

22. Në përfundim të kontrollit në raportin përmbledhës rekomandohet:

- a) të pezullohen veprimet, që kanë shkaktuar shkeljen;
- b) të propozohen detyra konkrete për përmirësimin e gjendjes;
- c) t'i sugjerohet Kontrollit të Lartë të Shtetit të ndërmarrë kontroll, duke i vënë në dispozicion aktin e kontrollit dhe raportin përmbledhës;

ç) t'i kërkohet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive verifikimin e pasurive dhe, nëse ka, konfliktin e interesave për individë të caktuar;

d) t'u njoftohen autoriteteve eprore apo të emërtesës, të cilat nuk janë në varësi të Këshillit të Ministrave, informacionin e grumbulluar dhe, me miratim të Kryeministrit, t'u kërkojë të ndërmarrin kontroll mbi këto organe dhe zyrtarë;

dh) të propozohet tek eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësit përgjegjës, masa disiplinore, deri në largimin nga detyra, për shkeljet ligjore apo të meta në punë të vëna re dhe të kontrollojë zbatimin e këtyre propozimeve;

e) në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të bëjë kallëzim penal pranë institucioneve përkatëse për personat përgjegjës.

Ministri i linjës për ministrinë përkatëse a institucionin qendror në varësi të tij dhe titullari i institucionit në varësi të Kryeministrit brenda 10 ditësh njofton Kryeministrin për zbatimin e masave konkrete.

23. Në rastet kur kontrolli vëren se vendimet, urdhrat, udhëzimet, rregulloret apo çdo akt tjetër i organeve të administratës shtetërore nuk përputhen me aktet ligjore në fuqi apo me parimet e administratës së një shteti të së drejtës, në aktkontroll përfshihet edhe rekomandimi për shfuqizimin, revokimin ose ndryshimin e tyre. Për aktet e ministrave, rekomandimi i dërgohet Kryeministrit. Gjithashtu, kur nga praktika e punës vërehet se për çështje të caktuara ka mangësi ligjore, si dhe në rastet kur aktet ligjore apo nënligjore, nuk sjellin pasojat e pritshme si pasojë e mangësive, pasaktësive, mungesës së harmonizimit e mospërputhjes, relacioni i rekomandon Kryeministrit nevojën për ndryshime së bashku me sugjerimet për ndryshime në aktet përkatëse.

VENDIM

kulturore nga partitë politike ose qeveria. Por Kushtetuta, përveç kësaj, mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet, për të cilat nuk mund t'i lërë hapësira rregullimi ligjvënës të zakonshëm.¹

Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese rithekson se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke i dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënës të zakonshëm, atëherë nuk është e nevojshme referimi te kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situate, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim, të respektojnë hierarkinë e akteve normative.²

Në vijim të logjikës juridike të përdorur më sipër dhe duke u kthyer konkretisht tek objekti i çështjes, Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjyqtari, për shkak të funksionit që ka, trajtohet nga Kushtetuta si funksion kushtetues. Si i tillë, ai gëzon, përveç të tjerave, mbrojtje të posaçme nga Kushtetuta. Kjo del qartë nga përmbajtja e dispozitës që parashikon shkarkimin e gjyqtarit, e cila është e ngjashme me atë të shkarkimit të zyrtarëve që ushtrojnë funksione të rëndësishme, duke përdorur të njëjtat standarte për këtë kategori funksionarësh shtetërorë.³ Megjithatë Kushtetuta ka parashikuar të njëjtin trajtim për këta funksionarë, një gjë të tillë nuk e kanë bërë ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse. Konkretisht, për zyrtarët e parashikuar nga nenet 128 (gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese), 140 (gjyqtarët e Gjykatës së Lartë) dhe 149 (Prokurori i Përgjithshëm) të Kushtetutës, nuk është bërë asnjë formulim tjetër në ligjet organike të tyre. E kundërta ka ndodhur për gjyqtarët e nivelit të parë dhe të dytë në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

Nisur nga këto arsye, Gjykata Kushtetuese konstaton se Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 147/6 të saj, sipas të cilit gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte a sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Ndërsa, sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, neni 147/4 i Kushtetutës ia ka deleguar kompetencat ligjvënës të zakonshëm, për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre. Në favor të këtij përfundimi flet edhe dispozita e nenit 46 të ligjit për pushtetin gjyqësor, e cila parashikon rastin e ankimit në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të shkarkimit nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë. Ky togfjalësh i përdorur nga ligjvënësi, përforcon edhe më shumë qëndrimin e mbajtur nga kjo Gjykatë.

Nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se pika 6 e nenit 42 të ligjit për pushtetin gjyqësor, që parashikon shkarkimin e gjyqtarit për shkelje të disiplinës, është e papajtueshme me pikën 6 të nenit 147 të Kushtetutës dhe për këtë arsye, ajo duhet të shfuqizohet. Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim, rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionin që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria.

Shkarkimi i gjyqtarit nga detyra sipas nenit 46/6 të ligjit, në referim të nenit 41, nuk përputhet me rastet konkrete të parashikuara nga neni 147/6. Parashikimi i shkarkimit nga detyra në të njëjtën dispozitë ligjore ku listohen edhe masat e tjera disiplinore, mënjanon aplikimin e nenit 147/6 të Kushtetutës, si dhe shkakton antikushtetutshmëri në procedimin e gjyqtarëve.

Shfuqizimi i kësaj dispozite nuk krijon boshllëk ligjor, sepse mund të zbatohet direkt rregullimi i nenit 147/6 të Kushtetutës. Në ndihmë të interpretimit të kësaj dispozite vjen edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e neneve 128, 140 e 149/2 të Kushtetutës, konkretisht i shprehjes "akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën".⁴ Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se kjo shprehje përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më tej, Gjykata Kushtetuese vazhdon me arsyetimin se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë

¹ Po aty

² Vendim nr.212, datë 29.12.2002 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

³ Krahazo nenin 147/6 me nenet 128 e 140 të Kushtetutës për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe me nenin 149 për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm

⁴ Vendim nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv, si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.¹

Përsa u përket dispozitave të tjera të kreut të V-të të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkesa nuk qëndron.

Sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, gjykata ose gjyqtari kryesisht, ose me kërkesë të palëve, mund të pezullojnë gjykimin e çështjes dhe t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, kur çmojnë se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejt midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në këto raste, ligji, në bazë të të cilit shqyrtohet çështja, bëhet pengesë për përfundimin e gjykitimit të saj, pa u shprehur më parë për të Gjykata Kushtetuese. Në rastin në shqyrtim, konstatohet se dispozitat e tjera, përjashtuar pikën 6 të nenit 42 të këtij kreu, nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me gjykimin e kërkesës konkrete që gjykohet dhe as bëhen pengesë për gjykimin e saj, sepse ato kanë të bëjnë me masat e tjera disiplinore, e jo me shkarkimin nga detyra. Pikërisht për këtë, Kushtetuta, në bazë të pikës 4 të nenit 147, ka autorizuar ligjvënësin që të bëjë një rregullim konkret në ligj. Bazuar në këto urdhërime të Kushtetutës, ligjvënësi ka rregulluar problemin e masave të tjera disiplinore me ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 40, duke qenë një dispozitë e përgjithshme me karakter deklarativ, përcakton se gjyqtarët kanë përgjegjësi për shkeljen e disiplinës, si dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve që diskreditojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, konstatohet se ajo përcakton që përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve ka të bëjë me shkeljen e disiplinës dhe me akte e sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e tyre dhe autoritetin e drejtësisë. Neni 41 ka përcaktuar se çfarë konsiderohet shkelje e disiplinës; ndërsa neni 42, përjashtuar pikën 6, ka përcaktuar masat që merren ndaj gjyqtarëve si për shkelje të disiplinës, dhe për akte e sjellje të tjera diskredituese.

Sa më lart, Gjykata Kushtetuese çmon se nenet 40, 41 dhe 42, përjashtuar pikën 6, trajtojnë masat disiplinore, që nuk kanë të bëjnë me masën e shkarkimit nga detyra, për të cilën bën fjalë neni 147/6 i Kushtetutës.

Është e vërtetë që në përmbajtjen e neneve 40, 41 e 42 të këtij ligji konstatohen mospërputhje në terminologjinë juridike të përdorur apo pasaktësi në aspekte të teknikës legjislative, por vetëm këto fakte nuk i bëjnë ato antikushtetuese.

Për nenet 43, 44, 45 të ligjit të kontestuar, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë parashtruar asnjë argument përse ato janë të papajtueshme me Kushtetutën. Në këto rrethana, përse kohë kërkuar disponon mbi objektin e kërkesës, kjo Gjykatë s’mund të shqyrtojë kërkesën tej objektit dhe shkaqeve të parashtruara në të.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131/a e 134/d të Kushtetutës, si dhe në nenet 68 e 70 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e pikës 6 të nenit 42 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
- Ky vendim i njoftohet Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ Shih për më tepër vendimin e mësipërm

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN	1500
PUBLIK.....	
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
.....	
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET...(suplement	1500
2006).....	
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Doli nga shtypi më 23.2.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë